



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Gllogocit
Zyra e Kryetarit



01 Nr. 020/04-34364 data 26/07 2021

Në vështrim të nenit 13 dhe 14.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores 12 nr.320-19338 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, rregullores MF-NR 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, nenit 49 të Ligjit Nr.05/L-031 Për Procedurat e Përgjithshme Administrative si dhe sipas propozimeve të dhëna në procesverbalin me nr. 01 nr. 060/04-34364, Kryetari i Komunës, mori këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve përmes thirrjes publike, nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2021.

I. Anëtarët e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve përmes thirrjes publike, nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2021, janë:

1. Agim Kastrati
2. Mehdi Ademi
3. Behxhet Binaku
4. Fluida Nika
5. Hazir Elshani
6. Lavdie Musliu (anëtare rezervë)

II. Komisioni ka për detyrë të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport për kërkesat për subvencionim përmes thirrjes publike për aplikim për vitin 2021, duke u bazuar në Rregulloren 12.Nr. 320-19338 për kushtet, kriteret dhe

procedurat e ndarjes së subvencioneve si dhe në Rregulloren MF-NR 04/2017
Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve

III. Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve përmes thirrjes publike për aplikim nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2021, punën e tyre duhet ta kryejnë me profesionalizëm të lartë dhe përkushtim.

IV. Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve përmes thirrjes publike për aplikim nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2021, ka për obligim që të shqyrtoj dhe vlerësoj të gjitha kërkesat pranë kësaj drejtorie në afatin kohor të përcaktuar me Rregullores 12 nr.320-19338 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve dhe rregullores MF-NR 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, dhe në të njëjtën kohë të njoftoj me shkrim Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimin e kërkesave.

V. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit,
- Zyrës së Personelit
- Anëtarëve të Komisionit
- Arkivit


KRYETARI I KOMUNËS

Ramir Lladrovci